



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7829 Prot.

Roskovec, më 04, 11 2023

VENDIM

NR 93 .DATË 30 . 11 .2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES KËSHILLIT BASHKIAK
PËR MUAJIN TETOR 2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 31.10.2023, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Tetor 2023.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6839/4 Prot.

Roskovec, më 01.11.2023

Procesverbal Nr.13

-I mbajtur sot, datë 31.10.2023, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së kaluar.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2023.
5. Për miratimin në parim dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Futbollit (FSHF).
6. Për dhënien e dakortësisë për marrjen në përdorim të Landfillit të mbetjeve urbane Fier nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë.
7. Për miratimin e projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut Nr.3, në qendër të qytetit Roskovec (Faza 1) .
8. Për shitjen e pronës së paluajtshme në pronësi të Bashkisë Rosovec, sipas programit “Banesë me kosto të ulët” .
9. Diskutim “Për unifikim të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”.
10. Informacion mbi procesin zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të kryesive dhe kryetarëve të fshatrave nën juridiksionin territorial të Bashkisë Roskovec.
11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁵

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Musko, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, A.Hoxha, A.Pelo, S.Bibo, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë: Zhaku Metushi, Pegiola Toro, Viola Çepele.

Prezent nga bashkia: Kryetarja M.Bufi, Nënkryetari M.Goga, Dr.Urbanistikës, P/Shërbimit Social, Dr.Ndërmarrjes së Pastrimit, Sp.Dr.Juridike, përfaqësues të shoqërisë së Ujësjetllës Kanalizime Fier.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari i Këshillit hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 17 këshilltarë. Para se të fillojë mbledhja disa punonjes të Qendrës PAK dhurojnë disa punime simbolike të bëra nga fëmijët e Qendrës për këshilltarët. Kryetari kërkon mirëkuptimin e këshilltarëve për renditjen e pikave, pikën 4 e ndryshon me pikën 9 për arsye se kemi të pranishëm sot përfaqësues të UK Fier, dhe për arsye kronologjie ndryshimin e pikës 5 me pikën 7. Pra nuk ndryshon asgjë, përveç renditjes së pikave. Dhurata-në emër të grupit propozojë që mbledhjet e ardhëshme të jenë online, si dhe duam të kemi rregulloren e këshillit. Kryetari-tani që ti po flet ne jemi duke u transmetuar live.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Hidhet në votim rendi i ditës me ndryshimet e propozuara si më sipër nga Kryetari dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së kaluar.

Dhurata-pyet për Odën e Bujqësisë që është miratuar në mbledhjen e fundit. Për arsye se ne nuk ishim në mbledhje, si u bë përzgjedhja e këtyre fermerëve, mbi çfare kriteresh, sepse duke parë raportin e numrit të fermerëve të shpërndarë në zona, vë re që Suku 1 nuk është përfshirë fare asnjë fermer, ku Suku 1 është zona më e madhe blegtorale dhe bujqësore, ka plantacione të mëdha me sera. Kryetari-detyrimi moral që kemi për të marr pjesë në mbledhje e ezauron edhe ngjysmën e pyetjes tuaj. Do marrësh përgjigje por do të lutesha ta lëm në pjesën e fundit të mbledhjes, tek pika “Diskutime dhe komente të qytetarëve”.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

4. Diskutim “Për unifikim të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”.

Kryetari- për këtë temë është mbajtur dhe një dëgjese publike. Dy përfaqësues nga ujësjellsit sqarojnë në video-monitor informacionin për unifikimin e tarifave të ujit të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura. Sqaron sipas materjalit që të gjithë këshilltarët kanë ndryshimin e tarifave për klientët familjar, publik, privat. Për të realizuar misionin e saj, për të arritur nivelin e treguesve të performancës, reformimi e shoqërive UK Patos, Roskovec, Mallakastër, Fier në vetvete solli një trashëgimi edhe të detyrimeve të tyre, gjë që nuk jemi në një situatë të mirë financiare. Prandaj lind nevoja që të bëhet ky unifikim i këtyre tarifave për të gjithë zonën ku shoqëria operon. Unifikimi do të bëhet gradualisht që edhe qytetarët të mos rëndohen. Fredi-vetëm për cilësinë e ujit nuk na thatë gjë, a është i pijshëm brënda parametrave, se abonentët e kanë nënshkruar kontratën për ujë të pijshëm, pra është apo nuk është ujë i pijshëm? Pse nuk është bërë më para nga kompania ulja e numrit të punonjësve, që të kishim më pak shpenzime? Punonjësja e UK sqaron në lidhje me numrin e punonjësve sipas planifikimeve. Arturi nga UK –monitorimi i ujit bëhet nga DSHP-ja, çdo muaj në pika të caktuara merren analizat e klorit, të mbetjeve dhe të cilësisë së ujit. Pra cilësia e ujit është e monitoruar, DSHP-ja na dërgon karakteristikat mujore, të cilat i dërgon edhe në bashki, ku paraqiten analizat për çdo pikë monitorimi. Amarildo-po e unifikoni në një faturë ujin e pijshëm dhe tarifën e ujërave të zeza? Sepse ka fshatra që nuk kanë fare kanalizime të ujërave të zeza, do jenë në një faturë këto? Punonjësja-vetëm ata që e marrin shërbimin do e marrin atë faturë dhe

tarifim. Ermira-për ta saktësuar pak, 60 lekë është për vitin 2024,65 lekë për vitin 2025 dhe 70 lekë për vitin 2026, do unifikohen të gjitha deri në 2026 sipas tabelës apo një nga një? Sa orë në ditë kanë furnizim me ujë të pijshëm Njësitë Administrative,si për shembull fshati Kurjan? Arturi-në Kurjan vërtet nuk ka 24 orë ujë të pijshëm, por po ta llogarisësh me volumin e ujit që prodhohet dhe shkon vërtet, ne nuk kemi pasur asnjëherë mungesë të volumit të ujit për plotësimin e nevojave, problem mbetet tek mënyra sesi ata e konsumojnë apo depozitojnë në depot e tyre, ose mënyrës si shpërdorohet uji në fshatra, si çarje e tubacioneve,rrjedhje etj. Ne po i bejmë propozim Entit Rregullator,ata e aprovojnë mënyrën e tarifimit të ujit. Kryetari-ne japim vetëm mendimin dhe pëlqimin për rritjen që parashikohet të bëhet tani. Ermira-ujë të jetë sa më cilësor sepse lë shumë për të dëshiruar,dhe të kemi ujë në Kurjan 24 orë, sepse unë për vete e grumbulloj ujin në 3 depozita, kam 2 pompa një që e çon ujin lart dhe tjetra që e zbret poshtë, është shumë shpenzim për një qytetar. Kryetarja e bashkisë-kjo është thjesht dhënie mendimi, nuk ka lidhje me miratim. Me të drejtë ka shumë kërkesa në lidhje me ujin dhe kanalizimet, unë propozoj që në mbledhjen tjetër të ftojme Drejtorin ose Administratorin e Përgjithshëm të Ujësjetës-Kanalizime që përgjigjet për Roskovecin, për të gjitha pyetjet dhe shqetësimet që ju keni, dhe për kërkesat që ka bërë bashkia për financime në ato zona ku nuk ka ujë të pijshëm, dhe për fshatrat që nuk kanë kanalizime të ujërave të zeza, pra ti ezaurojme atë ditë këto probleme. Dhurata-të vij dhe një person nga DSHP-ja për cilësinë e ujit. Kryetarja-po shumë e drejtë. Jorgo-ku kontrollon ky ujë nga DSHP-ja? Të kontrollohet edhe tek konsumatori, jo vetëm atje ku del uji. Në këtë moment vjen këshilltari Nazmi Zeka,u bën 18 këshilltarë. Elmazi-jam në një mendim me Kryetaren,ata janë kompetent për këto që ne po trajtojmë,për rritjen mos tu shkojë ndërmend fare, me nivelin dhe mirëqënien që ka populli i zonës tonë. Amarildo-do isha dakort me rritjen nëse uji do ishte i pijshëm dhe të vinte 24 orë, por ne të gjithë e dimë që asnjë nuk konsumon ujë nga çezma. Jam me mendimin që mos ta japim dakortësinë e rritjes së tarifave,të na bashkohen dhe kolegët e shumicës. Kryetari i Këshillit-pra ju po thoni që nuk jeni dakort me ndryshimet e kërkuara nga UK sh.a,në këto kushte që ofrohet ky shërbim si në cilësi dhe orar. Maksi- UK Roskovec në total ka vetëm 4% të aksioneve dhe mendimi juaj ka pjesën e vet në vendimmarrje, të cilin e merr Enti Rregullator. Elisabeta- ne do ishim të gjithë dakort të rritej nëse uji do ishte i pijshëm, me cilësinë dhe standartet e duhura. Fredi-ne jemi kundra sepse mbrojmë qytetarët tanë. Leksi- i pijshëm apo i papijshëm,i përdorshëm apo i papërdorshëm, këtu nuk ka vend për rritje të çmimit. Kryetari-mendimi që ne do i paraqesim ujësjetës është që ne nuk jemi dakort me propozimin dhe ndryshimin e kërkuar. Të gjithë anëtarët pjesmarrës shprehën mendimin kundër propozimit të Ujësjetës-Kanalizime sh.a Fier.

5.Për miratimin e projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut Nr.3,në qendër të qytetit Roskovec (Faza 1).

Dr.Urbanistikës Eneida e sqaron projektin në video-monitor në pamje 3D nga ana teknike. Qëllimi kryesor është rehabilitimi i një pjese të Bllokut Nr.3, i cili mbështetet në strategjinë territoriale të PPV të bashkisë Roskovec. Ka 4 nënobjekte kryesore :1.Fusha e sportit, 2.Stacioni i Policisë, 3.Parku i ri, 4.Kanali dhe rrugët lidhëse mbi kanal. Stadiumi do jetë bujtinë e fushës së sportit dhe njësi tragëtare. Në të dy anët e stadiumit do ketë njësi tregëtare, ku do formalizohet një pjesë e tregut të së dielës, kapaciteti 1800 vende,me standarte europiane,shkallare në dy anët,pjesa e tribunës dhe gjithë facilitetet. Parku i ri është menduar të jetë një ambient kreativ,multifunksional,sheshe për kënde lojrash,amfiteatër,pasazhe kalimi,minifushë. Kanali- do rehabilitohet i gjithë kanali, pjesa e kuqe në hartë do bëhet me tombino,pjesa blu do vishet me

beton. I gjithë kanali do mbulohet dhe do jetë pasazhe kalimi këmbësorësh. Kryetari- në rast të prurjes sasi uji të mëdha mund të përbëj problem,është llogaritur kjo? Kryetarja –patjetër që po,ai është kanal kullues,nuk është përrua. Eneida-në kthesë do ketë puseta të cilat ndihmojnë në uljen e shpejtësisë dhe kalimin normal të ujit. Sqaron Postën e Policisë,organizimin e gjithë sheshit që i dedikohet postës. Sqaron me shifra preventivat për të 4 nënobjektet. Kryetari i këshillit-nuk shoh tek preventivat mbi cilën tokë është zgjedhur,sepse nuk e shoh që të jetë i parashikuar shpronësimi. Kryetarja- që të realizohet ky projekt kërkon shumë burime financiare dhe ka shumë problematika ligjore të cilat duhen zgjidhur. Problemi i parë është i truallit,tokës mbi të cilin do zbatohet ky projekt. Ermira- na e tregon pak realisht se ku do jetë në terren,përveç fushës ku do jetë tjetër? Kryetarja- zona ku do zbatohet ky projekt është pjesa ku është sot fusha në anë të shkollës,kufizohet në dy anët e rrugës së unazës. Kjo tokë pjesërisht është truall dhe pjesërisht është tokë bujqësore,por duke qënë automatikisht e planifikuar për këtë projekt brenda PPV dhe PDV,automatikisht toka bujqësore kalon në tokë truall,dhe pronarët që e kanë sot këtë tokë nuk kanë të drejtë të ndërtojnë asgjë aty. Bashkia dhe qeveria kanë për detyrim tu dëmshperblej vlerën e truallit ose tokës bujqësore,sipas çmimit që ligji parashikon. Në buxhetin e bashkisë të këtij viti,e kemi të miratuar fondin e shpronësimit dhe e kemi lënë të paprekur. Postën e Policisë do e financojë Ministria e Brendëshme,kemi marr konfirmimin. Sqaron sistemimin e kanalit kullues,jashtë bllokut kanali do vishet me beton,brenda bllokut do vishet me tombino të mëdha. Në pjesën brenda bllokut Nr.3 do kemi një rrugë lidhëse,e cila del nga pjesa e Postës së Policisë dhe lidh dy anët e rrugëve të unazës.Fondi për këtë investim do përballohet nga buxheti i bashkisë vitin që vjen. Presim manualin e ri të çmimeve dhe do i rishikojmë të gjitha vlerat,pasi janë me manualin e vjetër. Do rishikojmë edhe afatin e punimeve. Ndërtimi i parkut të ri-ka një sipërfaqe toke e cila është bujqësore,kemi identifikuar emrat e pronarëve,kemi marr statusin juridik nga ASHK-ja e personave që preken. Banesa që është brenda këtij blloku nuk do preket,do ketë gjithë sipërfaqen e nevojshme sipas ligjit të legalizimit. Parku ka funksione të ndryshme për të gjitha moshat,dhe fondi për ndërtimin e tij do përballohet nga bashkia Roskovec. Kryetari i këshillit- qytetarët kanë marr dijeni? Kryetarja-akoma jo sepse nuk ka filluar zyrtarisht procedura e shpronësimit. Kryetari i këshillit-në mendimn tim qytetarët të cilët pretendohet se mund tju cënohet prona,mund të marrin një njoftim paraprak,sepse dikush atje mund të jetë në një fazë investimi. Marrja e dijenisë nuk mendoj se përben problem. Kryetarja-nuk mund të investoj pa marr leje në bashki. Nëse nuk vjen fondi nga Ministria e Brendëshme për Postën e Policisë,nuk e filloj dot zbatimin e projektit,kështu që nuk kam si ta informojë zyrtarisht qytetarin. Ne do bëjmë edhe dëgjese publike për këtë. Çdo qytetar kur investon paraqet kërkesë në bashki,dhe në këtë moment qytetarit do i bëhet e njohur destinacioni i tokës.Ne kemi patur problem me një qytetar në këtë zonë që ka bërë rrethim të paligjshëm dhe ka marr gjobë. Emels-ça rrethimi ka bërë pa leje se vuri dy bandiera? Në tokën tënde të marrësh leje? Kryetarja-po duhet marr leje.Kryetarja-pjesa më e rëndësishme e Bllokut Nr.3 është ndërtimi i stadiumit. Ky ministadium do bëhet në mënyrën e një qendre tregëtare për ti dhënë jetë dhe zhvillim zonës,por edhe për faktin që ne financiarisht nga bashkia nuk kemi mundësi ta ndërtojmë. Vetëm stadiumi shkon 1.9 miliard lekë,që do të thotë që për 3-4 vite bashkia të mos bënte asnjë investim tjetër. Fushën dhe ujitjen do i realizojë FSHF-ja. Rrethimi i fushës,ndërtimi i njërive tregëtare dhe gjithë ambjenti nga brenda,pjesën e ndenjësve të shkallareve do ti bëjmë përmes një koncensionit të partnetitetit publik privat PPP. Çdo qytetar,çdo biznes që ka interes,mund të futet të bëhet pjesë e këtij ndërtimi,me kushtin që pas përfundimit njësitë tregëtare ti marri ndërtuesi,dhe pjesët e brendëshme do i ketë bashkia. I kemi nisur shkresë

Agjensisë së Konkensioneve në Tiranë. Blloku Nr.3 është një nga projektet më të rëndësishme,jo vetëm që ndryshon gjithë pamjen e qytetit,por edhe anën funksionale të qytetit. Kryetari i këshillit-faleminderit Kryetare për prezantimin,më vjen mirë që kemi projekte të këtij niveli,që shkruajnë historinë dhe të ardhmen e qytetit. Amarildo- zotria që do marri për ndërtim njësitë tregtare,sa do e ketë afatin për të shfrytëzuar? Kryetarja-ne nuk e kemi filluar ende procedurën e konkensionit,presim të marrim miratimin nga agjensia. Është një procedurë që nuk e kemi bërë asnjëherë,grupi i juristëve në bashki po merren me detajimin e gjithë hapsirave ligjore. Në momentin që do kemi miratim nga agjensia do sqarojmë çdo detaj. Amarildo-si e keni menduar për pjesën e pazarit të dielën,kush do tregëtojë atje? Kryetarja-jemi duke hartuar një plan sesi do bëhet organizimi i tregut në këto njësi tregëtare,atje do tregëtojnë kryesisht biznese të mallrave industrial. Amarildo-në lidhje me pjesën e një banese që është në projekt,ligjërisht ti nuk ke të drejtë ta njoftosh,por moralisht unë do doja që ai të merrte një njoftim për pjesën që atje do bëhet një park,se do ishte jokomode për një familje të jetonte në një ambient të tillë sepse do ketë gjithë kohën zhurëm. Kryetarja-qytetari do njoftohet ashtu si do njoftohen gjithë të tjerët,në momentin që projekti do fillojë ligjërisht zbatimin. Qytetari që ka banesën atje do marri njoftim,banesa nuk do preket,do ti lejohet sipërfaqja e nevojshme sipas ligjit të legalizimit. Dhurata-mesa kupto va për ndërtimin e parkut dhe rrugët lidhëse e sistemimin e kanalit sponsor do jetë bashkia. A është në gjendje bashkia ti përballojë këto fonde ndërkohë që nëpër shkolla mungojnë detergjentët që janë jetike për shëndetin e fëmijëve? Kryetarja-vlerat që u prezantuan për dy projektet parku dhe rrugët lidhëse-kanalet dhe një pjesë nga fusha do jenë financim për 3 vite,pra do shpërndahen në 3 vite. Duke i shpërndarë në 3 vite jemi mjaftueshmërisht të aftë për ti financuar. Për shkollat që ti the unë nuk di që mos ti kemi plotësuar,jo vetëm për ato që përmende ti por për gjithçka. Fredi-sa është kostoja e shpronësimit dhe a do prishen objekte? Kryetarja-jo nuk ka prishje. Fredi-në lidhje me ish pronarët deri në këtë moment nuk di njeri asgjë,sa do jetë kostoja e shpronësimit të truallit,sepse na ka ndodhur që kemi miratuar parimisht kur kam qen këshilltar,një këshilltar e miratoj parimisht dhe pastaj po vihej në dyshim shtëpia e këshilltarit. Kryetarja-në brendësi të gjithë sipërfaqes ka vetëm një ndërtesë banimi,e cila nuk do të preket. Nëse nuk ka çertifikatë do ti lejohet vetëm sipërfaqja e nevojshme sipas ligjit të legalizimit. Vlera e shpronësimit aty ka dy kategori, tokë truall dhe tokë bujqësore,me gjithë vlerësimet që ne kemi bërë dhe sipas çmimit që ligji përcakton,është diku tek 98 milion lekë të vjetra,dhe ne kemi lënë në buxhet 100 milion lekë të vjetra për shpronësim. Amarildo-në lidhje me pjesën e stadiumit,a keni një marrëveshje me FSHF-në për të patur një ekip futbollit? Kryetarja-është i drejtë shqetësimi juaj,ne i kemi bërë kërkesë zyrtare FSHF-së edhe për ekipet zinxhir,edhe për federimin e skuadrës së Roskovecit,edhe për ndonjë ndihmesë për fushen.Federata Shqiptare na është përgjigjur pozitivisht. Amarildo-nga ana juaj është bërë përpjekje për formimin e një skuadre? Kryetarja-ta fillojmë njëherë si projekt.Kryetari i këshillit-kontributi për një skuadër nuk ngelet vetëm në dëshirën dhe mundësinë e bashkisë,por gjithsecili nga ne mund të japi kontributin tonë. Kryetari i këshillit-kërkon një sqarim për marrëdhënien PPP në rastin e stadiumit. Kryetarja-kjo ka të bëjë vetëm me ndërtimin e 4 rrethimeve,anët që rrethohet fusha,2 anët me shkallare nga brënda,poshtë tribunës do ketë hyrje ku do ndërtohen ambiente funksionale,ndërsa në pjesën e jashtme mbi fasadën do jetë ndërtimi i njësite tregëtare me akses nga jashtë. Këto 4 anë do jenë thjesht mure rrethuese. Pra kjo do jetë marrëdhënia me konkension dhe partneritet,vetëm këto 4 anët. Si të drejtë fitimi do kenë njësitë tregëtare. Kryetari i këshillit-proponon duke marr parasysh qytetarët qe do u shpronësohet prona,të shikohet mundësia që tu jepet atyre të parëve për ti shfrytëzuar këto ambiente,sepse në mendimin

tim ata janë të persekutuar që për një të mirë publike, atyre u merret pronë. Emels-përderisa nuk i është marr pëlqimi pronarit i cili është me certifikatë pronësie, koha është në dispozicion për ti marr pëlqimin, për tu ulur dhe për të gjetur një rrugë të mesme, sepse atij po i merret pa pëlqimin e tij. Kryetari i Këshillit-u shterua si përgjigje, u sqarua se në një moment të dytë do bëhet njoftimi. Kryetarja-mbledhjet e këshillit janë të hapura, çdo qytetar ka të drejtë të vij, të dëgjoj dhe në fund edhe të diskutojë. Askush nga qytetaret që ka ardhur nuk është nxjerrë jashtë. Çdo qytetar mund të vij në çdo moment të marr informacion, një qytetar unë e kam sqaruar vet që kjo është procedura, kështu do të bëhet. Edhe po mos të jem unë kryetare e të jetë një tjetër, ajo sipërfaqe atje është e destinuar për këtë gjë sipas PPV. Ka një procedurë ligjore të cilën jemi të detyruar ta zbatojmë. Gjërat kanë radhë pune dhe radhë ligjore. Në lidhje me mundësitë patjetër që atyre do u ofrohet të parëve, e rëndësishme është që ata të kenë besim në këtë gjë. Amarildo-mirë do ishte në rast se do ishte një investim publik, jo partneritet privat, për arsye se çënohet interesi duke i marr pronën. Kryetarja-po mos të kalojë me partneritet publik privat, jeni dakort ju që ato 1.9 miliard lekë ti nxjerrim nga bashkia, dhe për 3-4 vite bashkia të ngelet pa investimet e veta? Ky investim në shumicën e vet po bëhet nga bashkia, parku, rruga dhe pjesërisht fusha, Posta e Policisë nga qeveria, fusha nga Federata. Kemi gjetur një mënyrë harmonizimi që bashkia të ketë sa më pak kosto. Fredi-nëse pronari i banesës nuk ka dokumenta pronësie, kush na garanton, sepse nesër apo pasnesër atij mund ti prishet shtëpia? Kryetarja-unë të garantojë që nuk ka prishje edhe sikur të mos ketë certifikatë. Emels-ai pronari atje ka dhe një copë toke ku kaloi unaza dhe akoma nuk ka marr lekët e shpronësimit, përveç asaj tani po i merret dhe pjesa tjetër për të bërë parkun. Kryetarja-qytetarin e kam patur në zyrë dhe e kam sqaruar. Ne si bashki e kemi çuar 2 herë kërkesën në Agjensinë e Shpronësimeve Tiranë bashkë me projektin e unazës, i cili ka filluar jo kur kam qënë unë kryetare, por e kam gjetur të filluar projektin e unazës, dhe 2 herë Agjensia na ka kthyer të njëjtën përgjigje, që nuk bëhet shpronësimi kur ka mbaruar objekti. Në momentin që do fillonte unaza duhej të fillonte dhe procedura e shpronësimit. Nuk ka më diskutime. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit dhe prezantimit, dhe miratohet me 12 vota pro, 6 vota kundër nga koalicioni "Bashkë Fitojmë".

6. Për dhënien e dakortësisë për marrjen në përdorim të Landfillit të mbetjeve urbane Fier nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë. Maksi-në kushtet e Landfillit të Fierit i cili është i sekuestruar nga Spaku, jemi para faktit që mbetjet urbane nuk dorëzohen më, për arsye se iceneratori është i bllokuar. Që nga Qershori e kemi përdorur vetëm me mundësitë tona. Në kushtet e bllokimit të aktivitetit të iceneratorit, dhe nga përvoja e Elbasanit dhe Tiranës, vetëm fusha e mbetjeve 1/3 e sipërfaqes së iceneratorit kërkohet të merret në përdorim, me qera nga 4 bashkitë, me qellim që të depozitohen mbetjet në këtë fushë. Ne në këtë fushë do kemi aksion sipas banorëve dhe sasisë së mbetjeve, kjo do jetë deri në mbylljen e procesit të iceneratorit nga Spaku apo Prokuroria. Kërkohet marrëveshje që ne për sasinë që do dërgojmë, do kemi pagesat tona. Fredi-vazhdojmë të paguajmë tarife të iceneratorit? Nëse do merret me qera, do vazhdojmë akoma të paguajmë për iceneratorin, përveç këtyre që do paguajmë? Maksi-nga 1 Korriku ne nuk kemi bërë asnjë llojë pagese të iceneratorit, ndonëse kemi çuar mbetje atje. Pas marrëveshjes që do bëjnë, nuk do ketë absolutisht pagesë. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro.

7.Për miratimin në parim dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Futbollit (FSHF).

Kryetari-kjo marrëveshje është në kuadër të gjithë diskutimeve që u bën me rehabilitimin e Bllokut Nr.3,dhe është për ato pika që Bashkia me Federatën e Futbollit do të ketë në bashkëpunim. Eneida-sqaron projektin. Federata Shqiptare e Futbollit merr përsipër vetëm shtresat e barit dhe gjithë impjantin vaditës. Është një parim që FSHF-ja e ndjek dhe ne duhet të biem dakort. Bashkia ka për detyrim që tek kjo marrëveshje të realizojë të gjithë nënshtresat e fushës,sipas cilësimeve që FSHF-ja i ka. Federata do ketë kontrole të vazhdueshme deri në arritjen e fazës finale të shtrimit të barit natyral. Marrëveshjen e keni të gjithë bashkëlidhur projekt-vendimit,si dhe autorizimin e Kryetares së Bashkisë për nënshkrimin e kësaj marrëveshje. Jorgo-folëm për stadiumin,e dim shumë mirë që stadiumi duhet bërë,di që është një fond në bashki për sportin,ky fond i sportit nuk na thërret dhe neve për fëmijët tanë për të investuar,të krijohen grupet zinxhir,pse mos të lëm një fond që të krijohet ekipi,që të jenë gati kur të bëhet stadiumi? Ka kaç vite që jepet fondi për sportin,pse të mos investohet dhe për grupet zinxhir,që çdo fshat të ketë ekipet e tyre? Kryetari i këshillit-propozimi juaj qëndron,vetëm se është jashtë rendit që po diskutojmë. Maksi-fond deri tani të miratuar nga ana e këshillit apo bashkisë për sportin nuk ka pasur. Kryetari-brënda në buxhetin e bashkisë nuk ka fond specifik për sportin,të lutem ti referoheni saktë. Leksi-a është e gatshme FSHF-ja ta marrë përsipër ndërtimin e pjesës së tapetit,dhe sa larg në kohë do jetë kjo gjë? Maksi-është i miratuar në projektin e 100 fushave i Komitetit Ekzekutiv,priten vetëm këto procedura ligjore,siç është dhe ky vendim sot. Fredi-meqënëse është parimisht,jemi plotësisht dakort që të kalojë. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro.

8.Për shitjen e pronës së paluajtshme në pronësi të Bashkisë Roskovec sipas programit “Banesë me kosto të ulët”.

Specialistët e drejtorisë Juridike sqarojnë projekt-vendimin. Z.Afrim Çobo është banor i Njësisë Administrative Kurjan,fshati Kurjan,i cili ka mbetur i pastrehë për shkaqe të fatkeqësive natyrore dhe për këtë arsye propozojmë të trajtohet me banesë me kosto të ulët. Banesa është e llojit apartament. Veprimi juridik për kalimin e pronësisë nëpërmjet shitjes do të bëhet me akt noterial dhe do regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi. Përsa më sipër kërkujmë miratimin e këtij projekt-vendimi. Kryetari pyet nëse ka diskutime për këtë projekt-vendim. Nuk ka diskutime nga këshilltarët. Hidhet në votim projekt-vendimi “Për shitjen e pronës së paluajtshme në pronësi të Bashkisë Roskovec,sipas programit “Banesë me kosto të ulët”,sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 18 vota pro.

9.Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2023.

Fredi-në emër të transparencës,unë do doja që në çdo fshat të bashkisë Roskovec të ketë një kënd,një tabelë në qendër të fshatit,ku të lajmërohen,edhe ata që marrin ndihmë ekonomike të vendosen çdo muaj,se jo të gjithë kanë rrjete sociale. Të shikohet nga juristët kjo gjë nëse është ligjore. Ai kënd të shërbejë për çdo njoftim. Kryetari-do marrim mendimin e specialistëve se kush janë ato akte që mund të publikohen dhe ekspozohen. Elmazi-çdo njësi vendore ka kryepelqë dhe anëtarët e kryesisë të zgjedhur nëpër lagjet e tyre,të cilët janë më afër komunitetit dhe informojnë për çdo gjë,sepse ne nuk kemi të drejtë ti informojmë qytetarët nëpër tabela si në kohën e

Enverit,pse duhet tja ulim autoritetin ne si këshill? Prandaj unë jam i mendimit të zbatohet ligji. Hidhet në votim projekt-vendimi dhe miratohet unanimitisht me 18 vota pro.

10.Informacion mbi procesin zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të kryesive dhe kryetarëve të fshatrave nën juridiksionin territorial të Bashkisë Roskovec.

Maksi-në mbledhjen e fundit të këshillit është raportuar për detyrën e ngarkuar si nënkryetar i bashkisë për ndjekjen së bashku me këshillin të zgjedhjeve të anëtarëve të kryesive dhe kryetarëve të fshatrave. Ishin përfunduar zgjedhjet në 11 fshatra,kishin ngelur pa u zgjedhur në 3 fshatra, në Ngjeqar,Strum dhe Luar. Nga këto Ngjeqari dhe Luari ka përfunduar me sukses. Problem është vetëm Strumi. Në Strum për arsye familjare të ish kryetarit të fshatit dhe për mospjesmarrje të disa lagjeve,nuk ka përfunduar akoma procesi. Shumë shpejt do përfundojë dhe do vij para jush një informacion tjetër. Kryetari-në zbatim të këtij vendimi,të bëjmë një shtesë për mbledhjen e radhës,sikundër kemi ngritur strukturat komunitare në zonat rurale,kërkohej që të ngrejmë dhe strukturat komunitare në zonën urbane. Duke u bazuar në legjislacionin që ne kemi,të marim vendim për këtë dhe të realizojmë dhe zgjedhjet në zonën urbane,për të përcaktuar përfaqësuesit komunitar dhe në lagjet e qytetit. Maksi-jam dakort,të vij me projekt-vendim sipas ligjit.

11.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Dhurata-çfarë po bëhet me çështjen e qytetarit Gazmend Boranji? Maksi-proçesi nuk ka nevojë për koment,dokumentat i kanë shkuar Spakut,para drejtësisë nuk flasim dot. Dhurata-te shkolla 9 vjeçare “5 Dëshmorët” ku unë punoj,ai mikropylli i shkollës është i mbuluar nga ferrat,nuk ka punëtor bashkia ti presi këto ferra,që fëmijët të luajnë e të argëtohen edhe pse atje nuk ka asnjë stol? Problem është edhe mungesa e detergjentëve në shkollë. A mund të vendosen disa stola atje jashtë për fëmijët,që ta hanë ushqimin ulur? Më shqetësuese është prerja e ferrave. Maksi-për të dyja problematikat,në projekt-buxhetin e vitit 2024 do të shtojmë një sanitare në atë shkollë. Në kushtet që punimet nuk kanë përfunduar,nuk marrim dot masa se jemi akoma në punime,nëse nuk ka marrëveshje me firmën,do i vendosim ne vet stolat dhe koshat. Sa i përket prerjes së ferrave që sot po e marr përsipër që brenda javës të mbarojë pastrimi i ferrave. Amarildo-shqetësim nga banorët e fshatit Vidhishtë për pastrimin e përroit,atje derdhen ujërat e zeza,duke mos patur dhe ujë shumë shpejt gjatë stinës së verës aty do të ketë një epidemi. Maksi-në dëgjuesën publike që patëm në Njësinë Administrative Kuman,kemi dhënë 3 prioritete kryesore,dhe një nga ato prioritete është përroi i Vidhishtës për 2024. Amarildo-banorëve u shërbehet ujë 30-40 minuta në ditë,ça problemi ka atje që u shërbehet kaq pak ujë? Ata nuk mbushin dot as depozitat. Maksi-gjatë vitit 2024 është miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i Ujësjellës-Kanalizime Fier miratimi i ujësjellësit për Njësinë Administrative Kuman. Amarildo-është depozituar një kërkesë nga taksistët e licensuar pranë bashkisë Roskovec,për vendqëndrime në Roskovec,Kuman dhe diku tjetër,të vijëzuar si e parashikon ligji,por nuk kanë marr akoma përgjigje. Maksi-janë 2 vende taksish,nëse nuk janë të mjaftueshme do e shikojmë. Leksi-a do të ketë investim për Unazën Perëndimore? Maksi-ai është investim i qeverisë,jemi akoma në tentativë për të thithur fonde. Leksi-ne penalizohemi nga kjo gjë,ndoshta të bëhen pjesë-pjesë investimet. Fredi- në fshatin Ngjeqar së fundmi është shfaqur një konflikt midis dy personave,Baki Shabani dhe Haxhi Shabani. Bashkia në qoftë se nuk vepron me formularin 6,të vej ti ndaj atje,sepse kemi agronom,kemi formularin 6,ne po bëhemi pjesë e konfliktit. Nëse nuk bëhemi pjesë e zgjidhjes së konfliktit,do ti çojmë në vëllavrasje. Maksi-ne jemi bërë pjesë e zgjidhjes së konfliktit,kemi çuar komision për matjet,i kemi thirrur, kemi bërë

ballafaqimin këtu në bashki,prë është objekt i punës tonë,dhe kemi njoftuar vazhdimisht policinë,pra jemi marrë me këtë punë. Kryetari- kujton se është në nderin e këtij këshilli ti lexoni deri në fund projekt-vendimet klo tu lutesha kryetareve të komisioneve dhe komisioneve përkatëse,që pasi njihen me rendin e ditës,të marrin masa për mbledhjen e komisioneve. Kryetari- njofton së pranë këshillit do të ngrihet një komision i ri i Integritimit European. Ju lutem të jeni bashkëpunues,të bëhen propozime nga tre grupimet që ne kemi,për këtë komision. Duke përshëndetur dhe qytetarët që e ndoqën live këtë mbledhje,Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

